

SHPALLJE KËRKESE PËR SHPRONËSIM

Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit shpall kërkesën “Për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private (tokë-arë) për ndërtimin e dy rezervuarëve të ujit të pijshëm në kuadër të projektit për zonën rurale të qytetit të Durrësit”.

Subjekti kërkuar i këtij objekti është sh.a. Ujësjellës-kanalizime, Durrës. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vemë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga komisioni i shpronësimit pranë Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, për secilin person, sipas listës emërore të mëposhtme.

Ky publikim do të jetë me periudhë njëjavore dhe brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, personat që kanë emrat në listën emërore kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit).

PRONARËT QË DO TË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I REZERVUARIT TË UJIT TË PIJSHËM NË FSHATIN KATUND I RI

Nr.	Emri, mbiemri	Sip/tokë arë	Çmimi tokës/m ² (lekë)	Vlera në (lekë)
1	Z.Vath Çurbja	1400 m ²	1150	1 610 000
2	Z.Hysen Çyrbja	200 m ²	1150	230 000
		Totali/lekë		1 840 00

PRONARI QË DO TË SHPRONËSOHET NGA NDËRTIMI I REZERVUARIT TË UJIT TË PIJSHËM NË FSHATIN MANËZ TË BASHKISË MANËZ

Nr	Emri, mbiemri	Sip/tokë arë	Çmimi objektit/m ² (lekë)	Vlera në (lekë)
1	Qamil Kurti	1075	1000	1 075 000

Vlera totale e shpronësimit është 2 915 000 (dy milionë e nëntëqind e pesëmbëdhjetë mijë) lekë.